

TEUHIDI

BAZA E FESË ISLAME

SHEJH ABDULMUHSIN EL-ABBAD



Titulli: Teuhidi, Baza e Fesë Islame (transkriptim)

Autori: Shejh AbdulMuhsin El-Abbad

Burimi: <https://www.youtube.com/watch?v=FXLIQoOKvbl>

Përkthyesi: Orgest Beja

Përshtati në tekst: JL

© 2026, Të gjithë të drejtat janë të përkthyesit



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Bismilahi Er-Rrahmani Er-Rrahim

(Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit)

Lavdërimet i takojnë Zotit të botëve, lavdërimet e shumta, bekimet dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi robin dhe të Dërguarin e Tij, Profetin tonë Muhammed dhe mbi të gjithë familjen dhe shokët e tij, e më pas:

Thotë Allahu *Azze ue Xhel-le* në Librin e Tij madhështor:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿١﴾
الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ
رِزْقًا لَكُمْ فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أَنْدَادًا وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٢٢﴾

“O ju njerëz, adhuronit Zotin tuaj, i Cili ju krijoi ju dhe ata që qenë para jush, që të mund të bëheni të devotshëm.

I Cili e ka bërë tokën vendpushim për ju dhe i Cili zbrit nga qielli ujë, dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju. Atëherë pra, mos i vini ortak Allahut (në adhurim) kur ju e dini (se vetëm Ai ka të drejtë të adhurohet e askush tjetër)” **[Surja El-Bekareh, 21-22]**

Këto dy ajete nga Libri i Allahut *Azze ue Xhel-le*, në fillimet e Sures El-Bekareh, përfshijnë rreth urdhëresës më të madhe dhe ndalesës më të madhe. Urdhëri më i madh është *Teuhidi* dhe ndalesa më e madhe është *Shirku*, ky urdhër dhe kjo ndalesë, është urdhri i parë në Kur'an dhe ndalesa e parë në Kur'an.

Teuhidi me fjalë të thjeshta është të besosh se Allahu është i Vetmi Zot (Krijues), dhe Sunduesi i gjithçkaje dhe i Vetmi që meriton të adhurohet (si për shembull: *t'i lutesh vetëm Atij, të falesh vetëm për Të, të bësh kurban vetëm për Të, të agjërosh vetëm për Të, të betohesh vetëm për Të* etj.), duke u larguar nga çdo lloj idhujtarie, dhe të besosh në Emrat dhe Cilësitë e Allahut ashtu siç kanë ardhur në Fenë Islame.

Teuhidi i Allahut *Azze ue Xhel-le* është gjëja e parë që është urdhëruar në Kur'an dhe Shirku është gjëja e parë që është ndaluar në Kur'an.

Urdhëri i parë që gjen ai i cili fillon leximin e Kur'anit nga fillimi i tij, është urdhëri për Teuhidin, dhe ndalesa e parë që vjen pas saj është ndalesa për Shirkun.

Atëherë pra, këto dy ajete, në to është urdhëri i parë në Kur'an dhe ndalesa e parë në Kur'an, në to është urdhëri më i madh që është dhënë dhe ndalesa më e madhe,

Sepse *urdhëri më i madh është Teuhidi dhe ndalesa më e madhe është Shirku.*

Allahu *Azze ue Xhel-le* i krijoi krijesat për adhurim, i krijoi krijesat për adhurimin e Tij dhe i urdhëroi ato për Teuhidin e Tij si dhe bindjen ndaj Tij. Ka thënë Allahu *Azze ue Xhel-le*:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ ﴿٥٦﴾

“Dhe nuk i kam krijuar xhinnët dhe njerëzit vetëm se të më adhurojnë” [Surja Edh-Dharijat, 56]

Domethënë se Ai i ka krijuar ata duke i ngarkuar me adhurimin e Tij, duke i urdhëruar ata dhe duke i ndaluar, duke i urdhëruar ata për Teuhidin dhe duke i ndaluar ata nga Shirku, pastaj ata ndahen në (dy lloje):

në atij që i është dhënë sukses dhe në të poshtëruar.

I suksesshëm, i cili, dorëzohet dhe nënshtrohet (Allahut), i kryen urdhëresat dhe u largohet ndalesave dhe ai, i cili është në kundërshtim me këtë, i lë urdhëresat dhe bie në haramë (ndalesa), i lë urdhëresat dhe bie në haramë.

Fjala e Allahut Azze ue Xhel-le:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ ﴿٢١﴾

“O ju njerëz, adhurojeni Zotin tuaj” [Surja El-Bekare, 21]

Ky është urdhër për adhurim, **“Adhurojeni Zotin tuaj”**.

Urdhër për adhurim, i cili është haku i Allahut Azze ue Xhel, dhe në fund të ajetit tjetër (thotë):

فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أَنْدَادًا وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٢٢﴾

“Atëherë pra, mos i vini ortak Allahut (në adhurim) kur ju e dini (se vetëm Ai ka të drejtë të adhurohet e askush tjetër)” [Surja El-Bekare, 22]

Dhe kjo është ndalesë ndaj Shirkut, i cili është e kundërta e Teuhidit, ndërsa adhurimi është hak i Allahut.

Ka ardhur në dy Sahihat (Bukhari dhe Muslim) nga Muadh ibn Xhebel (radijAllahu ‘anhu) se ai ka qenë mbrapa Profetit ﷺ hipur mbi gomar dhe i tha atij: **“O djalosh”**, pastaj heshti, i thashë: **“Të përgjigjem o i Dërguari i Allahut”**, pastaj heshti (Profeti salAllahu alejhi ue sel-lem), pastaj tha: **“O Muadh”** dhe thashë: **“Të përgjigjem o i Dërguari i Allahut”**, pastaj heshti, dhe më pas tha: **“O Muadh”**. Thashë: **“Të përgjigjem o i Dërguari i Allahut.”** Tha: **“A e di cili është haku i Allahut mbi robërit dhe cili është haku i robërve ndaj Allahut?”** Thashë: **“Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë!”** Tha: **“Haku i Allahut mbi robërit e Tij, është që ata ta adhurojnë Atë dhe të mos i shoqërojnë Atij ortak...”**,

- ta adhurojnë Atë dhe të mos i shoqërojnë Atij ortak, ky është haku i Allahut mbi robërit.

“...ndërsa haku i robërve mbi Allahun është që të mos i dënojnë ata.”, pra nëse ata e adhurojnë Atë dhe shpëtojnë prej Shirkut, haku i tyre mbi Të është që të mos i dënojnë ata,

porse t'i shpërblejë ata dhe t'i fusë në Xhennet, nëse e adhurojnë dhe e lënë Shirkun, i cili bie ndesh me adhurimin dhe e kundërshton atë.

I Dërguari ﷺ në këtë hadith me Muadhin dëshiroi ta përgatisë dhe ta lajmërojë Muadhin me këtë çështje të madhe të cilën do t'ja sqarojë atij, dhe kjo është prej plotësueshmërisë së sqarimit të tij *salAllahu alejhi ue sel lem* dhe prej plotësueshmërisë së këshillës për Ummetin e tij *alejhi-salatu ue sel-lam*.

Ai është njeriu më këshillues për njerëzit dhe njeriu më i mirë për të këshilluar, dhe më i përkryeri për të sqaruar, mbi të qofshin lëvdatat e shumta dhe shpëtimi i plotë. E plotësoi thirrjen ndaj Muadhit, ndërsa Muadhi i përgjigjej me:

“Të përgjigjem o i Dërguari i Allahut”, dhe ai (ﷺ) e përsëriti këtë tri herë, pastaj tha:

“A e di cili është haku i Allahut mbi robërit dhe cili është haku i robërve ndaj Allahut?”

Të gjitha këto çështje të shtyjnë për t'u përgatitur dhe për të njohur rëndësinë që do t'i jepet atij, pra mbi Muadhin *radijAllahu anhu*, të folurit tek ai tri herë, gjithashtu fjala drejtuar atij ***“A e di cili është haku i Allahut mbi robërit dhe cili është haku i robërve ndaj Allahut?”***. E gjitha kjo ishte që ai të përgatitet për atë që do i thoshte atij, dhe se kjo është një çështje e madhe dhe një çështje e rëndësishme, e ajo është njohja e adhurimit të Allahut, njohja e urdhërit më të madh, i cili është adhurimi i Allahut dhe njohjen e ndalesës më të madhe, e cila është Shirkun. Ka thënë (Profeti ﷺ):

“Ta adhurojnë Atë e të mos i shoqërojnë Atij asnjë ortak”.

Ky është kuptimi i ajetit:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ

“O ju njerëz, adhuroni Zotin tuaj” [Surja El-Bekareh, 21]

Dhe pastaj ka thënë:

فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أَنْدَادًا وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٢٢﴾

“Atëherë pra, mos i vini ortak Allahut (në adhurim) kur ju e dini (se vetëm Ai ka të drejtë të adhurohet e askush tjetër)” [Surja El-Bekareh, 22]

(Këto ajete përmbajnë) urdhër për Teuhidin dhe ndalesën nga Shirku, urdhër për Teuhidin dhe ndalesën nga Shirku.

I Dërguari ﷺ kur e dërgoi Allahu, filloi të thërriste (njerëzit) në *“Fjalën e Sinqertë”*, në Fjalën e Teuhidit,

dhe ajo është *La ilahe il-lAllah*. Ai ﷺ thërriste tek kjo fjalë, i shkonte njerëzve në vendet që ata mblidheshin, në tregjet e tyre në të cilat grumbulloheshin dhe i thoshte:

“O ju njerëz, thoni La ilahe il-lAllah që të shpëtoni, o ju njerëz, thoni La ilahe il-lAllah që të shpëtoni.”

Ajo është gjëja e parë që është urdhëruar për të dhe gjëja e parë që është ndaluar e që është Shirku, në Kur'an gjëja e parë që është urdhëruar në ajet është Teuhidi dhe në ajet tjetër ndalesa e parë që është Shirku, dhe kjo është një çështje tjetër se gjëja e parë që është urdhëruar njeriu është Teuhidi.

Mosbesimtari, gjëja e parë që ftohet (në Islam) është Teuhidi, i thuhet atij: thuaj **“La ilahe il-lAllah”** ose thuaj **“Esh’hedu en La ilahe il-lAllah ue en-ne Muhammeden ResuluLlah”**.

I Dërguari ﷺ kur e dërgoi Muadhin në Jemen i hartoi atij planin që duhet të ecë dhe e orientoi atë që të fillojë me gjënë më të rëndësishme. I tha atij:

“O Muadh, ti po shkon në një popull të cilët janë Ehlil Kitab (çifutët dhe të krishterët), dhe le të jetë gjëja e parë që i fton ata dëshmia La ilahe il-lAllah ue en-ne Muhammeden ResuluLlah”

La ilahe il-lAllah – Askush nuk ka të drejtë (nuk meriton) të adhurohet përveç Allahut

Esh’hedu en La ilahe il-lAllah ue en-ne Muhammeden ResuluLlah – Dëshmoj se askush nuk ka të drejtë (nuk meriton) të adhurohet përveç Allahut dhe se Muhammedi (ﷺ) është i Dërguari i Allahut

Gjëja e parë që ftohet për tek ajo është Teuhidi, i Dërguari ﷺ gjëja e parë në të cilën ftoi ishte Teuhidi, (Ai thoshte):

“O ju njerëz, thoni La ilahe il-lAllah që të shpëtoni”,

“O ju njerëz, thoni La ilahe il-lAllah që të shpëtoni”.

E tha këtë me veprën e tij, me veten e tij, dhe e urdhëroi Muadhin ta vepronte këtë kur e dërgoi në Jemen.

(I tha atij): **“Ti po shkon në një popull të cilët janë Ehlil Kitab (çifutët dhe të krishterët), dhe le të jetë gjëja e parë që i fton ata dëshmia La ilahe il-lAllah ue en-ne Muhammeden ResuluLlah”.**

Gjëja e parë që ftohet tek ajo është Teuhidi. I tha (Profeti ﷺ):

“Nëse ata të përgjigjen ty (pozitivisht) në këtë gjë”, pra dëshmojnë **“La ilahe il-lAllah ue en-ne Muhammeden ResuluLlah”** kanë hyrë në Islam, i tha atij: **“Mësoji ata”** ... hapi i dytë i cili vijon, **“Mësoji ata se Allahu i ka bërë obligim pesë namaze çdo ditë e natë, e nëse të përgjigjen (pozitivisht) në këtë gjë, mësoji ata se Allahu i ka bërë obligim që të nxjerrin sadaka (Zekatin) nga pasuria e tyre, e cila merret prej pasanikëve të tyre dhe u jepet fukarenjve të tyre, e nëse ata të përgjigjen (pozitivisht) në këtë gjë, ki kujdes që të mos i marrësh pasuritë më të vlefshme të tyre dhe ki frikë prej lutjes së atij që i është bërë padrejtësi, sepse ndërmjet saj dhe Allahut nuk ka pengesë.”**

Pra nëse ata futen në Islam, dhe pastaj falen dhe e nxjerrin Zekatin, ti mos i bëj padrejtësi askujt që t’i marrësh atij më shumë se çë ka ai hak (për të dhënë), sepse haku (i Zekatit) është mesatarja e pasurisë, jo shumë mirë e as shumë e keqe, Zekati nxirret nga mesatarja e pasurisë, nuk merret nga më e mira e saj dhe as nga më e keqja e saj, porse merret nga mesatarja e tyre.

La ilahe il-lAllah – Askush nuk ka të drejtë (nuk meriton) të adhurohet përveç Allahut

Esh’hedu en La ilahe il-lAllah ue en-ne Muhammeden ResuluLlah – Dëshmoj se askush nuk ka të drejtë (nuk meriton) të adhurohet përveç Allahut dhe se Muhammedi (ﷺ) është i Dërguari i Allahut

Kur (Profeti ﷺ) e urdhëroi që të marrë zekatin nga të pasurit dhe t'i jepet të varfërve, e orientoi dhe e paralajmëroi prej padrejtësisë, e ajo është: marrja e pasurisë më të vlefshme, që t'u marrë pasurinë më të mire, pasurinë më të shtrenjtë, kjo është padrejtësi, nuk lejohet.

Pra e paralajmëroi Profeti Muadhin *radijAllahu anhu* prej saj, dhe i tha: ***“Bëj kujdes”*** ... Ky është paralajmërim! ... ***“Bëj kujdes të mos i marrësh pasurinë më të vlefshme”***

, bëj kujdes që të mos marrësh pasurinë më të mire tek pronarët e saj, të shtrenjtë tek ata, më të çmuar tek ata,

“Bëj kujdes mos i marrësh ato”,

pra do të thotë se marrja e tyre është padrejtësi, pastaj tha:

“ki frikë prej lutjes së atij që i është bërë padrejtësi” ... që do të thotë se nëse ti e merr pasurinë e tyre më të vlefshme, atëherë i ke bërë padrejtësi, dhe ata mund të luten kundër teje e lutja e atij që i është bërë padrejtësi, nuk ka ndërmjet saj (lutjes) dhe Allahut pengesë.

“Nëse ata të përgjigjen ty (për dhënien e Zekatit) bëj kujdes mos i marrësh pasurinë më të vlefshme dhe ki frikë prej lutjes së atij që i është bërë padrejtësi, sepse ndërmjet saj dhe Allahut nuk ka pengesë.”

Pra i Dërguari ﷺ, gjëja e parë që ftoi ishte Teuhidi dhe gjëja e parë që orientoi për tek ajo Muadh ibn Xhebelin kur e dërgoi në Jemen ishte që të ftonte në Teuhid.

Teuhidi është gjëja e parë që është urdhëruar për të, ndërsa Shirku është gjëja e parë që është ndaluar prej saj, ndërsa Shirku është gjëja e parë që është ndaluar prej saj. Ashtu siç Teuhidi është gjëja e parë që kërkohet në jetë që të ftohet mosbesimtari në Islam, ftohet në Teuhid, dhe ashtu siç fillon jeta e lumtur me Teuhid, gjithashtu duhet mbyllur me Teuhid.

Shirku (do të thotë: *Idhujtaria*), e cila është e kundërta e *Teuhidit*. Shirk është të vendosësh dike ose diçka në një pozitë që i takon vetëm Allahut në adhurim ose në Cilësitë e Tij hyjnore! Për shembull, të besosh se dikush tjetër përveç Allahut ka fuqi të krijojë, të furnizojë, të kontrollojë ngjarjet në gjithësi, të jape jetën, të marrë jetën. Të adhurosh dike tjetër përveç Allahut, si për shembull: t'i lutesh apo t'i falesh një varri, një statujë, një peme, një njeriu, diellit, hënës, apo çdo gjëje të krijuar, të bësh kurban për to, t'i biesh në ruku apo në sexhde këtyre, apo të betohesh për dike tjetër përveç Allahut, etj. *Shirku (Idhujtaria) është gjynahu më i madh në Fenë Islame.*

Ka thënë (Profeti ﷺ):

“Përkujtojini të vdekurit prej jush (ata të cilëve u është afruar vdekja) me La ilahe il-lAllah, sepse kush e ka fjalën e tij të fundit në dunja La ilahe il-lAllah do të hyjë në Xhennet.”

Përkujtojini pra ata që janë gati duke vdekur, të cilëve iu është afruar vdekja, nuk është për qëllim përkujtimi pasi të vdesin, sepse nëse vdes, mbaroi çështja prej vendbanimit të veprave dhe kalon në vendbanimin e shpërblimit, pra nuk i përkujtohet Teuhidi dhe Shehadeti pasi të vdesë, porse i përkujtohet për atë kohë sa është në jetë që të vdesë në të dhe ta mbyllë jetën me të. Dhe prandaj ka thënë:

“Përkujtojini ata që janë duke vdekur me La ilahe il-lAllah, sepse ai që do ta ketë fjalën e tij të fundit në dunja La ilahe il-lAllah do të hyjë në Xhennet.”

Pra kuptimi i saj është se i kërkohet për atë kohë sa është në jetë, jo pas vdekjes, përkujtimi është kur është i gjallë, para se të vdesë, i thuhet atij që i është afruar vdekja, kur ai i është afruar asaj, kur ai i është afruar asaj.

“Përkujtojini të vdekurit tuaj me La ilahe il-lAllah”, pra ata të cilët iu janë afruar vdekjes, dhe e sqaron këtë fjala e tij (ﷺ):

“Ai që e ka fjalën e tij të fundit në dunja”, pra kuptimi i saj është se nuk bëhet përkujtimi pas vdekjes, sepse fjala e tij (ﷺ): ***“Ai që e ka fjalën e tij të fundit në dunja La ilahe il-lAllah”***, domethënë se kjo gjë është e kërkuar në dunja, nuk është e kërkuar pas vdekjes, pra përkujtimi bëhet për ata që iu është afruar vdekja, të cilët janë afër vdekjes, të cilët janë në fundin e tyre të jetës së dunjasë, që iu janë afruar botës tjetër, atyre duhet t’ju përkujtohet Shehadeti, duhet të përkujtohen me *La ilahe il-lAllah*, e cila është *Fjala e Singëritetit*,

atëherë pra ajo është fillimi dhe ajo është mbarimi, ajo është fillimi që të futet në Islam, (siç ka thënë Profeti ﷺ):

“O ju njerëz, thoni La ilahe il-lAllah që të shpëtoni”, dhe gjithashtu fjala e tij (ﷺ):

“Ti po shkon në një popull ku janë Ehlil Kitab (çifutët dhe të krishterët), dhe le të jetë gjëja e parë që i fton ata dëshmia La ilahe il-lAllah ue en-ne Muhammeden ResuluLlah”

dhe ajo është gjëja e fundit që duhet mbyllur jeta me të, (siç ka thënë Profeti ﷺ):

“Përkujtojini ata të cilëve iu është afruar vdekja me La ilahe il-lAllah, sepse ai i cili e ka atë fjalën e tij të fundit në dunja La ilahe il-lAllah do të hyjë në Xhennet.”

Dhe siç thashë, se kërkohet prej atij që i është afruar vdekja dhe për këtë ka shembuj siç është fjala e tij ﷺ :

“Akshami është uutri i ditës”, Akshami nuk është ditën por është natën. Sepse nata hyn me perëndimin e diellit dhe namazi i Akshamit është pas perëndimit të diellit porse është afër ditës, është uutri i ditës sepse vjen pas (fundit të) ditës direkt, sepse ajo është afër ditës dhe i thuhet asaj *uutri i ditës*, sepse është shumë afër ditës, sepse ezani i Akshamit është ndarësja midis natës dhe ditës, dhe Akshami vjen pas saj direkt, sepse ajo është shumë afër ditës. Kjo është prej të njëjtit lloj me (hadithin):

“Përkujtojini ata të cilëve iu është afruar vdekja me La ilahe il-lAllah”, afër vdekjes, pa vdekur akoma.

Namazit të Akshamit i është thënë se është uutri i ditës, porse ajo nuk është ditën por është shumë afër ditës.

Kështu edhe në një hadith tjetër në të cilin thotë Profeti ﷺ për festën e Fitrit: ***“Dy muajt e festave nuk pakësohen”***, dy muajt e festave, pra Ramazani dhe festa e Fitrit nuk është në Ramazan porse është në (muajin) Sheual, porse thuhet për Ramazanin muaji i festës, festa nuk është në të, porse dita e parë e saj, dhe quhet ajo që i afrohet diçkaje, me emrin e asaj gjëje. Pra atëherë fjala (e Profetit ﷺ): ***“Përkujtojeni të vdekurit prej jush (ata të cilëve u është afruar vdekja) me La ilahe il-lallah”***, është prej këtij lloji që përmendëm, dhe për këtë ka thënë në vijim të hadithit : ***“Ai që e ka fjalën e tij të fundit në dunja La ilahe il-lallah do të hyjë në Xhennet”***.

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ ﴿٢١﴾

“O ju njerëz, adhurojeni Zotin tuaj” [Surja El-Bekareh, 21]

“Adhurojeni Zotin tuaj”, është urdhër për adhurim, e çfarë është adhurimi?

Kanë thënë disa dijetarë:

Ai (adhurimi) është emër gjithëpërfshirës për çdo gjë që do Allahu dhe është i Kënaqur prej fjalëve dhe veprave, të shfaqura e të fshehta.

Ai është emër gjithëpërfshirës për çdo gjë që do Allahu dhe është i Kënaqur.

Dhe për adhurimin ka disa lloje të shumta, prej tyre janë:

lutja, frika, shpresa, mbështetja, tmerri, pendimi, kërkimi i ndihmës, kërkimi i mbrojtjes, kërkimi i rrizkut, betimi e të tjera prej llojeve të adhurimit, të gjitha këto janë prej llojeve të adhurimit, dhe ky është kuptimi i Teuhidit Uluhijeh, i cili është Teuhidi i Adhurimit, sepse Teuhidi Uluhijeh është adhurimi i Allahut me veprat e robërve,

që t'i kryejnë adhurimet e tyre në veçanti për Të, nuk i shoqërojnë Allahut ortak në adhurimin e tyre për Të.

Ka thënë Allahu *Azze ue Xhel-le*:

وَأَنَّ الْمَسَاجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا ﴿١٨﴾

“Dhe vërtet që xhamitë janë për Allahun (të Vetëm), kështu që mos lutni asnjë tjetër bashkë me Allahun”
[Surja El-Xhin, 18]

وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي
سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ ﴿٦٠﴾

“Dhe Zoti juaj thotë: “M’u lutni Mua dhe Unë do t’ju përgjigjem (lutjes suaj). Me të vërtetë se ata të cilët e përbuzin adhurimin ndaj Meje, ata pa dyshim që do të hyjnë në Xhehenem me poshtërim”” [Surja Ghafir, 60]

Pra lutja (dua) është adhurim, madje ka thënë i Dërguari ﷺ :

“Lutja është adhurimi”, ka thënë i Dërguari ﷺ : **“Lutja është adhurimi”**

Fjala e Allahut *Azze ue Xhel-le*: اَعْبُدُوا رَبَّكُمْ ﴿٢١﴾

“Adhurojeni Zotin tuaj” [Surja El-Bekareh, 21] do të thotë: veçojeni Atë me adhurim, dhe Teuhidi është veçimi i Allahut me adhurim. *Teuhidi është veçimi i Allahut me adhurim, ndërsa Shirku është e kundërta e tij dhe ajo është që të adhurohet bashkë me Allahun të tjerë përveç Tij,*

dhe të bëhet bashkë me Allahun ortak në adhurim, pastaj ky ortak që i bëhet bashkë me atë (në adhurim), çfarë është ai? Është vetë i krijuar, sepse Allahu është i Vetmi Krijues dhe çdo gjë përveç Tij është e krijuar. Dhe nëse njeriu adhuron Allahun dhe bashkë me Të edhe të tjerë, kuptimi i saj është se ka adhuruar një krijesë sikur vetë Ai. Dhe si mund të logjikohet, dhe si i takon që një krijesë të adhurojë një krijesë tjetër? *Krijesat adhurojnë Krijuesin, dhe nuk duhet që të krijuarit të adhurojnë të krijuarit sikur ata, dhe për këtë shkak ka qortuar Allahu ata që adhurojnë me Allahun të tjerë përveç Tij.*

Ka thënë (Allahu Azze ue Xhel-le):

إِنَّ الَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ عِبَادٌ أَمْثَالُكُمْ ط

“Sigurisht se ata që i lutni në vend të Allahut, ata vetë janë robër si edhe ju” [Surja El-A’raf, 194]

Si mund të adhuron krijesën e Allahut, e cila nuk ekzistonte dhe e solli Allahu në ekzistencë, siç ishit ju që nuk ekzistonit dhe ju solli Allahu në ekzistencë. Ata të cilët i adhuron bashkë me Allahun kanë qenë inekzistentë dhe i solli Allahu në ekzistencë, si mund të adhuron atë që ishte inekzistent dhe i cili pastaj do të vdesë! I cili ka fillim dhe mbarim. Adhurimi është për Atë që s’ka fillim dhe s’ka mbarim *Subhanehu ue Te’ala.*

I Pari, i Cili s’kishte asgjë para Tij dhe i Fundit, i Cili s’ka asgjë pas Tij, adhurimi është për Allahun, nuk duhet për të tjerë veç Tij, nuk duhet për të tjerë përveç Allahut, dhe ai i cili adhuron me Allahun të tjerë, ka adhuruar një krijesë bashkë me Allahun (pra i ka shoqëruar Atij ortak), dhe si mund të logjikohet që i krijuari të adhurojë të krijuarin si vetë ai.

Ishte inekzistent dhe e solli Allahu në ekzistencë, ky që adhuron krijesën ishte inekzistent dhe e solli Allahu në ekzistencë. S'ka asnjë dallim midis robit dhe të adhuruarit që është prej krijesave, të gjithë ishin inekzistentë dhe i solli Allahu në ekzistencë, i nxori ata nga inekzistenca për në ekzistencë, porse Ai që duhet të adhurohet është

El-Hajju El-Kajjum (I Gjalli i Përjetshëm, I Panevojshmi për krijesat), i Cili nuk ka fillim për Të as nuk ka mbarim për Të.

Ai është i Pari e nuk kishte asgjë para Tij, dhe i Fundit, nuk do të ketë asgjë pas Tij *Subhanehu ue Te'ala*, adhurimi është për Atë. E kështu, i Dërguari ﷺ kur e pyeti Ibn Mes'udi *radijAllahu anhu* (ka thënë):

“Thashë: O i Dërguari i Allahut, cili gjynah është më i madh tek Allahu?

Tha (i Dërguari ﷺ): ***“T'i bësh Allahut shok (ortak), ndërkohë që Ai të ka krijuar”***...”

T'i bësh Allahut shok, ndërkohë që Ai të ka krijuar, pra Allahu është Ai i Cili të ka krijuar dhe i bën Atij ortak?!

Ai (idhulli) është i krijuar sikurse ti, fjala ***“ndërkohë që Ai të ka krijuar”*** sqaron se Krijuesi është Ai i Cili e meriton adhurimin, i Vetmi, dhe se krijesat nuk meritojnë të adhurohen, sepse ai është sikurse ti, o ti adhurues.

Tha (Profeti) ﷺ duke sqaruar gjynahun më të rëndë:

“T'i bësh Allahut shok, ndërkohë që Ai të ka krijuar”

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ

“O ju njerëz, adhurojeni Zotin tuaj” [Surja El-Bekareh, 21]

Ky është Teuhidi i Adhurimit, Teuhidi Uluhijeh, Teuhidi i Allahut *Azze ue Xhel-le* me veprën e robërve, që robërit t'i kryejnë veprat e tyre me sinqeritet vetëm për Fytyrën e Allahut *Subhanehu ue Te'ala*. Nuk lusin vetëm se Allahun, nuk i mbështeten tjetër vetëm se Allahut, nuk kërkojnë ndihmë vetëm se prej Allahut. Pra nuk lejohet për njeriun të shkojë tek varri i të vdekurit dhe të thotë:

“o filan më ndihmo, o filan më jep këtë, o filan më realize këtë gjë, o filan unë nuk bëj dot pa ty, dua nuse, dua fëmijë, dua këtë e atë...”, këto çështje nuk kërkojnë vetëm se prej Allahut, nuk kërkojnë prej dikujt tjetër përveç Allahut, as prej të vdekurve, as prej melaikëve (engjëjve), as prej xhinnëve dhe as prej njerëzve që s'janë prezent (në momentin që e kërkon).

Ndërsa nëse është thirrja e atij që s'është prezent nëpërmjet telefonit për shembull, duke i folur atij, duke i thënë:

“dua prej teje këtë, më ndihmo për këtë”, kjo është njësoj sikur ai të ishte prezent, porse nëse i lut ata që s'janë prezent, lut xhinnët, lut melaiket (engjëjt), duke u kërkuar ndihmë atyre, kjo është kërkim ndihme jo prej Allahut. Kjo është kërkim ndihme prej krijesave, melaiket janë të krijuar, xhinnët janë të krijuar, si dhe njerëzit janë të krijuar, ndërsa Allahu *Azze ue Xhel-le* është i Vetmi Krijues, i Cili meriton adhurimin, nuk ka krijues tjetër përveç Allahut, e as nuk meriton adhurimin askush përveç Allahut, dhe për këtë arsye ka thënë pas kësaj, pasi tha:

اعْبُدُوا رَبَّكُمْ ﴿٢١﴾

“Adhurojeni Zotin tuaj” [Surja El-Bekareh, 21], ka thënë:

الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ ﴿٢٢﴾

“I Cili ju krijoi ju dhe ata që qenë para jush” [Surja El-Bekareh, 21]. Që domethënë, ju ka krijuar juve dhe ata që kanë qenë para jush, popujt e mëhershëm, Allahu është Ai që i ka krijuar,

dhe juve që po ju drejtohet thirrja, Allahu është Ai që ju ka krijuar, pra atëherë adhuroni vetëm Krijuesin, dhe mos adhuroni krijesat.

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿٢١﴾

“O ju njerëz, adhurojeni Zotin tuaj, i Cili ju krijoi ju dhe ata që qenë para jush që të mund të bëheni të devotshëm”
[Surja El-Bekareh, 21]

Pra realizohet devotshmëria, e cila është kapja pas asaj që ka ardhur prej Allahut dhe të Dërguarit ﷺ.

Devotshmëria është që robi të vërë ndërmjet tij dhe Zemërimit të Allahut mbrojtëse, që të ruhet prej saj, dhe kjo duke kryer urdhëresat dhe duke ju shmangur ndalesave.

Dhe çështja më e madhe që duhet zbatuar është adhurimi i Allahut, adhuroje Allahun, dhe çështja më e madhe që duhet larguar nga ajo është adhurimi i të tjerëve bashkë me Allahun.

Ka thënë (Allahu) në fillim të ajetit: اعْبُدُوا رَبَّكُمُ ﴿٢١﴾

“Adhurojeni Zotin tuaj” [Surja El-Bekareh, 21]

dhe ka thënë në fund të ajetit tjetër:

فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أُنْدَادًا وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٢٢﴾

“Atëherë pra, mos i vini ortak Allahut (në adhurim) kur ju e dini (se vetëm Ai ka të drejtë të adhurohet e askush tjetër)” [Surja El-Bekareh, 22]

Pasi që urdhëroi për adhurimin (e Tij), dhe se adhurimi bëhet vetëm për Zotin, përmendi disa cilësi, të cilat janë Veprat e Tij, dhe të cilat tregojnë që të veçohet me adhurim, siç është i veçuar me krijimin (e krijesave) dhe me sjelljen e tyre në ekzistencë, pra Ai është i Cili duhet veçuar me adhurim (pra adhurimi të jetë vetëm për Të).

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿٢١﴾
الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ فِرَاشًا ﴿٢٢﴾

“Adhurojeni Zotin tuaj, i Cili ju krijoi ju dhe ata që qenë para jush, që të mund të bëheni të devotshëm. I Cili e ka bërë tokën vendpushimi për ju.” [Surja El-Bekareh, 21-22]

, dhe e bëri atë të lehtë për të jetuar.

هُوَ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ ذُلُولًا فَأَمْشُوا فِي مَنَاكِبِهَا وَكُلُوا مِنْ رِزْقِهِ ﴿١٥﴾

“Ai është Ai i Cili e ka bërë tokën të dobishme dhe të përshtatshme për ju, kështu që ecni nëpër rrugë dhe hani nga rrizku (të mirat e furnizimi)” [Surja El-Mulk, 15]

أَفَلَا يَنْظُرُونَ إِلَى الْآيَاتِ كَيْفَ خُلِقَتْ ﴿١٧﴾

وَالِإِلَى السَّمَاءِ كَيْفَ رُفِعَتْ ﴿١٨﴾

وَالِإِلَى الْجِبَالِ كَيْفَ نُصِبَتْ ﴿١٩﴾

وَالِإِلَى الْأَرْضِ كَيْفَ سُطِحَتْ ﴿٢٠﴾

“Ai nuk i shohin devetë, se si janë krijuar? Dhe qiellin, se si është ngritur? Dhe malet se si janë ngulur e qëndruar fort? Dhe tokën, se si është shtruar?” [Surja El-Ghashijeh 17-20]

E shtruar që të qëndrojnë njerëzit dhe të jetojnë në të, të cilën e ka bërë vend pushimi dhe qiellin kulm.

Qiejt janë të ndërtuar (njëri sipër tjetrit) sipër njerëzve, tokën e ka bërë vend pushimi, ndërsa qiellin kulmin e saj, toka poshtë tyre si vend pushimi ndërsa qiejt sipër tyre si kulm.

الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً ﴿٢٢﴾

“I Cili e ka bërë tokën vendpushim për ju dhe qiellin si kupë, dhe ju zbret nga qielli ujë” [Surja El-Bekareh, 22]

Qielli në këtë ajet është për qëllim lartë, sipër, sepse qielli i parë është qiell i ndërtuar (mbi të qiejt e tjerë), shtatë qiej.

وَالسَّمَاءَ بِنَاءً ﴿٢٢﴾

“dhe qiellin si kupë” [Surja El-Bekareh, 22]

Pra qiejt që janë të mbivendosura, sipër, të cilat janë e kundërta e tokës. Fjala e Tij:

وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ ﴿٢٢﴾

“i Cili zbret nga qielli” [Surja El-Bekareh, 22],

do të thotë prej lart.

Nuk është zbritja (e shiut) prej qiejve të mbivendosur, sepse shiun e krijon Allahu midis qiellit dhe tokës, e cila bëhet re, pastaj e bashkon atë, pastaj e bën atë re masive (me ujë).

Dhe tha:

وَالسَّحَابِ الْمُسَخَّرِ بَيْنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ ﴿١٦٤﴾

“dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit dhe tokës” [Surja El-Bekareh, 164]

ءَأَنْتُمْ أَنْزَلْتُمُوهُ مِنَ الْمُزْنِ أَمْ نَحْنُ الْمُنْزِلُونَ ﴿٦٩﴾

“A jeni ju që e bëni të bjerë nga retë (shiun), apo jemi Ne që e zbresim?” [Surja El-Uakiah, 69]

Elmuzni (e përmendur arabish në ajet) janë retë që janë midis qiellit dhe tokës. Ka thënë:

وَالسَّحَابِ الْمُسَخَّرِ بَيْنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ ﴿١٦٤﴾

“dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit dhe tokës” [Surja El-Bekareh, 164],

domethënë midis qiejve të mbivendosur dhe tokës.

Fjala e Tij se e zbreti prej qiellit, domethënë prej lart, sepse Allahu i çon retë, pastaj vendos tek to ujë, pastaj e zbret atë, mbi atë të cilën e dëshiron prej tokave, pra qielli i parë është tjetër nga qielli i dytë, sepse ka thënë:

وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ ﴿٢٢﴾

“I Cili zbret nga qielli” [Surja El-Bekareh, 22],

domethënë nga lart, i cili është midis qiellit dhe tokës, nga retë. Dhe për këtë ka thënë:

وَالسَّحَابِ الْمُسَخَّرِ بَيْنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ ﴿١٦٤﴾

“dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit dhe tokës” [Surja El-Bekareh, 164].

Domethënë Allahu e ka nënshtruar atë, e ka sjellë atë dhe e ka krijuar atë midis qiellit dhe tokës, pastaj e zbret atë.

وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَكُمْ ﴿٢٢﴾

“Dhe ju zbret nga qielli ujë, dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju” [Surja El-Bekareh, 22]

E zbret shiun në tokë, Allahu ngjall nëpërmjet saj bimësinë dhe e nxjerr rrizkun prej fryteve, dhe farave e nga të tjera përveç tyre, nga ajo e cila kanë njerëzit nevojë (për të), Allahu i Lartësuar i nxjerr ato nga toka.

وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَّكُمْ ۖ

“Dhe ju zbret nga qielli ujë, dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju” [Surja El-Bekareh, 22]

Pra frytet i nxjerr nga toka si shkak i këtij uji, pastaj ka thënë:

فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أَنْدَادًا ۖ

“Atëherë pra, mos i vini ortak Allahut (në adhurim)” [Surja El-Bekareh, 22]

I Cili i bën këto veprime, dhe është i veçuar me këto veprime, Ai është i Cili duhet adhuruar, atëherë pra kemi dy Teuhide:

Teuhid Rububijeh dhe Teuhid Uluhijeh.

Është Teuhid Uluhijeh në Fjalën e Tij:

اعْبُدُوا رَبَّكُمُ

“Adhuroni Zotin tuaj” [Surja El-Bekareh, 21]

dhe në Fjalën e Tij:

فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أَنْدَادًا ۖ

“Atëherë pra, mos i vini ortak Allahut (në adhurim)” [Surja El-Bekareh, 22]

dhe Teuhid Rububijeh në Fjalën e Tij:

الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ ۖ

“I Cili ju krijoi ju dhe ata që kanë qenë para jush” [Surja El-Bekareh, 21]

الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَّكُمْ ۖ

“I Cili e ka bërë tokën vendpushim për ju dhe qiellin si kupë, dhe ju zbret nga qielli ujë, dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju” [Surja El-Bekareh, 22]

Këto janë Veprat e Allahut, i cili është Teuhidi Rububijeh, Teuhidi Rububijeh është veçimi i Allahut me Veprat e Tij.

Veprat e Tij, të cilat janë: Krijimi, Rizku, Sjellja në jetë, Vdekja dhe të vepruarit në Gjithësi, këto janë Veprat e Allahut.

Allahu i Lartësuar është i Vetëm në Veprat e Tij, nuk ka ortak në to, Ai është Krijuesi i Vetëm, dhe nuk ka Krijues tjetër përveç Tij. Atëherë obligohet që të jetë Ai i Adhuruari i Vetëm, dhe të mos adhurohet askush tjetër përveç Tij.

Në ato dy Ajete është Teuhidi Rububijeh dhe Teuhidi Uluhijeh.

Teuhidi Uluhijeh në Fjalën e Tij:

اعْبُدُوا رَبَّكُمُ ﴿٢١﴾

“Adhurojeni Zotin tuaj”

فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أَنْدَادًا ﴿٢٢﴾

“Atëherë pra, mos i vini ortak Allahut (në adhurim)”.

Dhe Teuhidi Rububijeh në Fjalën e Tij:

الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ ﴿٢٣﴾

“I Cili ju krijoi ju dhe ata që kanë qenë para jush” [Surja El-Bekareh, 21]

الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَكُمْ ﴿٢٤﴾

“I Cili e ka bërë tokën vendpushim për ju dhe qiellin si kupë, dhe ju zbret nga qielli ujë, dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju” [Surja El-Bekareh, 22]

Dhe shumë prej (ajeteve) që vijnë në Kur'anin Kerim, është aprovim për Teuhidin Rububijeh, si detyrim i atij që e aprovoi atë (Teuhidin Rububijeh, që ta pranojë edhe) Teuhidin Uluhijeh, dhe kjo sepse mosbesimtarët që u dërgua tek ata i Dërguari ﷺ e pranonin Teuhidin Rububijeh porse ata e mohonin Teuhidin Uluhijeh. E aprovonin Teuhidin Rububijeh (siç ka thënë Allahu):

وَلَيْن سَأَلْتَهُمْ مَنْ خَلَقَهُمْ لَيَقُولَنَّ اللَّهُ ﷻ ﴿٢٥﴾

“Dhe nëse i pyet ata se kush i ka krijuar, do të thonë: Allahu!” [Surja Ez-Zuhruf, 87]

وَلَيْنَ سَأَلْتَهُمْ مَنْ خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ لَيَقُولُنَّ اللَّهُ ۚ

“Dhe nëse i pyet ata: Kush i ka krijuar qiejt dhe tokën? Do të thonë: Allahu!” [Surja Lukman, 25]

Ata e aprovojnë se Allahu është Krijuesi i Vetëm, Ai është Furnizuesi, se Ai jep jetën dhe vdekjen, e aprovojnë këtë, porse ata nuk hynë në Islam me këtë Teuhid që e aprovuan, sepse ajo që kërkohet është ta adhurojnë Allahun! Porse ata nuk e veçuan Allahun të Vetëm me adhurim, porse adhuruan krahas Allahut edhe të tjerë. Dhe kur i Dërguari ﷺ i urdhëroi me Teuhid, e mohuan atë dhe thanë:

أَجْعَلِ الْآلِهَةَ إِلَهًا وَاحِدًا إِنَّ هَذَا لَشَيْءٌ عَجَابٌ ۚ

“A i ka bërë ai zotat në një Zot (Allahu)? Vërtet që kjo është një gjë e çuditshme!” [Surja Sad, 5]

Kjo do të thotë se ata ndiqnin fenë e baballarëve dhe gjyshërve të tyre. (Gjithashtu është ajeti):

وَكَذَلِكَ مَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ فِي قَرْيَةٍ مِّنْ نَّذِيرٍ إِلَّا قَالَ مُتْرَفُوهَا إِنَّا وَجَدْنَا آبَاءَنَا عَلَىٰ أُمَّةٍ وَإِنَّا عَلَىٰ آثَرِهِمْ مُّقْتَدُونَ ۚ

“Dhe po kështu, Ne nuk dërguam ndonjë këshillues para teje (o i Dërguar) në ndonjë vendbanim, por veçse ata të kamurit nga mesi i tij do të thoshin: “Ne gjetëm baballarët tanë të ndjekin një lloj feje dhe sigurisht që ne do të ndjekim gjurmët e tyre.”” [Surja Ez-Zuhruf, 23]

Kuptimi i saj është se ata ndiqnin rrugën e baballarëve dhe gjyshërve të tyre, ndërsa gjyshërit e tyre nuk e adhuronin Allahun të Vetëm, porse adhuronin Atë dhe krahas Atij adhuronin edhe të tjerë. Dhe ajo që është e ditur është se, *adhurimi nëse bëhet për dikënd tjetër përveç Allahut, ai adhurim është njësoj sikur nuk ekziston.*

وَقَدِمْنَا إِلَىٰ مَا عَمِلُوا مِنْ عَمَلٍ فَجَعَلْنَاهُ هَبَاءً مَّنْثُورًا ﴿٢٣﴾

“Dhe Ne do t’u qasemi veprave që kanë bërë ata (mosbesimtarët) dhe do t’i bëjmë veprat e tilla si grimca puhuri të shpërndara” [Surja El-Furkan, 23]

Sepse adhurimi duhet të jetë vetëm për Allahun, dhe ky është kuptimi i *La Ilahe il-lAllah*, sepse kuptimi i *La Ilahe il-lAllah* përmban *mohim* dhe *pohim*. Mohon adhurimin për çdokënd tjetër përveç Allahut dhe e pohon atë vetëm për Allahun.

Fjala e Teuhidit (*La Ilahe il-lAllah*) ka dy shtylla, *mohim* dhe *pohim*. Mohim në fillimin e saj që është: *La Ilahe* (nuk meriton adhurimin me hak askush) dhe Pohim në pjesën e dytë: *il-lAllah* (përveç Allahut), pra kuptimi është se ti mohon se nuk duhet adhuruar askush përveç Allahut dhe e pohon atë vetëm për Allahun. Ky është kuptimi i *La Ilahe il-lAllah*, mohon adhurimin për çdokënd tjetër përveç Allahut dhe e pohon atë vetëm për Allahun. Ky është kuptimi i adhurimit, dhe ky është kuptimi i Fjalës së Teuhidit, mohim dhe pohim. Adhurimi duhet vetëm për Allahun, të Vetëm, dhe nuk duhen adhuruar krahas Allahut të tjerë. Ashtu siç Ai është Krijuesi i Vetëm, kështu dhe nuk ka ortak në krijim, gjithashtu obligohet të jetë i Vetmi i Adhuruar dhe të mos i shoqërohet Atij ortak në adhurim.

Dhe për këtë vjen në Kur'an aprovimi i Teuhidit Rububijeh, të cilin e kanë aprovuar atë mosbesimtarët, për t'i bërë të detyrueshme atyre Teuhidin Uluhijeh.

أَمَّنْ خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَأَنْزَلَ لَكُمْ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَنْبَتْنَا بِهِ حَدَائِقَ ذَاتَ
بَهْجَةٍ مَا كَانَ لَكُمْ أَنْ تُثْبِتُوا شَجَرَهَا ﴿٦٠﴾

“A ka më të mirë se Ai i Cili krijoi qiejt dhe tokën, dhe dërgon për ju ujë nga qielli nga ku Ne bëjmë të lulëzojnë kopshte të mrekullueshme? Nuk është në aftësitë tuaja të sillni rritjen e pemëve të tyre (pa këtë ujë)” [Surja En-Neml, 60]

Ky është Teuhidi Rububijeh, nuk është për qëllim aprovimi vetëm i këtij Teuhidi. Ajo është Fjala (vazhdimi i ajetit):

أَأَلَّهُ مَعَ اللَّهِ بَلْ هُمْ قَوْمٌ يَعِدُونَ ﴿٦١﴾

“A ka ndonjë Zot tjetër me Allahun? Jo, kurrë! Por ata janë njerëz që i përshkruajnë (Atij) shokë si të barabartë me Të.” [Surja En-Neml, 60]

Pra e aprovoi Teuhidin Rububijeh për të bërë të detyrueshme Teuhidin Uluhijeh, i Cili është i veçuar me krijim dhe sjelljen në ekzistencë të krijesave, Ai është i Adhuruari i Vetëm (Zoti i vetëm). Ashtu siç nuk ka Krijues tjetër përveç Allahut, ashtu edhe nuk ka të adhurar me të drejtë përveç Allahut, nuk ka të adhurar përveç Allahut.

أَمَّنْ خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَأَنْزَلَ لَكُمْ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَنْبَتْنَا بِهِ حَدَائِقَ ذَاتَ
بَهْجَةٍ مَا كَانَ لَكُمْ أَنْ تُثْبِتُوا شَجَرَهَا ﴿٦١﴾

“A ka më të mirë se Ai i Cili krijoi qiejt dhe tokën, dhe dërgon për ju ujë nga qielli nga ku Ne bëjmë të lulëzojnë kopshte të mrekullueshme? Nuk është në aftësitë tuaja të sillni rritjen e pemëve të tyre (pa këtë ujë)” [Surja En-Neml, 60]

Allahu është Ai i Cili rrit (pemët), pastaj ka thënë (në vazhdim të ajetit):

أَأَلَّهُ مَعَ اللَّهِ بَلْ هُمْ قَوْمٌ يَعْدِلُونَ ﴿٦٠﴾

“A ka ndonjë Zot tjetër me Allahun? Jo, kurrë! Por ata janë njerëz që i përshkruajnë (Atij) shokë si të barabartë me Të.” [Surja En-Neml, 60],

domethënë se ata vendosin barazi mes Krijuesit dhe krijesave. Pastaj ka thënë:

إِذْ نَسَوَیْكُمْ رَبِّ الْعَالَمِیْنَ ﴿٩٨﴾

“Kur ne ju mbajtëm ju (për zota të rremë) si të barabartë (në adhurim) me Zotin e Gjithësisë” [Surja Esh-Shu’ara, 98]

Pra e kanë bërë të barabartë Krijuesin me krijesat, dhe i kanë bërë krijesat të adhuruar bashkë me Allahun, e ndërkohë ata janë prej llojit të tyre (njerëz sikurse ata),

إِنَّ الَّذِیْنَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ عِبَادٌ أَمْثَالُكُمْ ﴿١٩٤﴾

“Sigurisht se ata që ju i lutni në vend të Allahut, ata vetë janë robër si edhe ju” [Surja El-A’raf, 194]

Atëherë pra Teuhidi Rububijeh vjen si obligueshmëri për (ta aprovuar edhe) Teuhidin Uluhijeh.

Pastaj ka thënë:

أَمَّنْ جَعَلَ الْأَرْضَ قَرَارًا وَجَعَلَ خِلَالَهَا أَنْهَارًا وَجَعَلَ لَهَا رَوَاسِيَ وَجَعَلَ بَيْنَ الْبَحْرَيْنِ حَاجِزًا أَلَيْسَ اللَّهُ بِأَكْثَرُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٦١﴾

“A ka më të mire se Ai që e ka bërë tokën të qëndrueshme, ka bërë në të lumenj, ka ngritur në të male dhe ka bërë midis dy deteve pengesë të padukshme?! Vallë, a ka krahës Allahut zot tjetër?! Jo, por shumica e tyre janë të paditur!” [Surja En-Neml, 61]

أَمَّنْ يُجِيبُ الْمُضْطَرَّ إِذَا دَعَاهُ وَيَكْشِفُ السُّوءَ وَيَجْعَلُكُمْ خُلَفَاءَ الْأَرْضِ أَلَيْسَ اللَّهُ بِكَافٍ عَبْدًا ﴿٦٢﴾

“A ka më të mire se Ai që i vjen në ndihmë nevojtarit të këputur, kur i lutet Atij, që jua largon të keqen dhe ju bën trashëgimtarë në tokë?! Vallë, a ka krahës Allahut zot tjetër?! Sa pak që reflektoni!” [Surja En-Neml, 62]

أَمَّنْ يَهْدِيكُمْ فِي ظُلُمَاتِ الْبَرِّ وَالْبَحْرِ وَمَنْ يُرْسِلُ الرِّيْحَ بُشْرًا بَيْنَ يَدَيْ رَحْمَتِهِ أَلَيْسَ اللَّهُ تَعَالَى عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿٦٣﴾

“A ka më të mire se Ai që ju rrëfen rrugën në errësirat e tokës dhe të detit dhe ju çon erërat si lajmëtarë të Mëshirës së Tij? Vallë, a ka krahës Allahut zot tjetër? I Lartësuar qoftë Allahu dhe i Lavdëruar mbi çdo gjë që ia shoqërojnë (në adhurim)” [Surja En-Neml, 63]

أَمَّنْ يَبْدُوُ الْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيدُهُ، وَمَنْ يَرْزُقُكُمْ مِّنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ أَلَيْسَ اللَّهُ قُلْ هَاتُوا بُرْهَانَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٦٤﴾

“A ka më të mire se Ai, që e fillon krijimin dhe pastaj e përsërit atë, që ju jep mjete jetese nga qielli dhe toka?! Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër? Thuaj (o i Dërguar): Sillni provat tuaja, nëse ajo që thoni është e vërtetë!”
[Surja En-Neml, 64]

Ajete në të cilat aprovon Allahu Teuhidin Rububijeh për të bërë të detyrueshëm (për të njohur) Teuhidin Uluhijeh. Sepse ai që e pranon se Allahu është i Vetmi Krijues, i Vetmi Furnizues, obligohet mbi të që të pranojë se Allahu është i Vetmi i adhuruar (me të drejtë).

Ashtu siç nuk ka Krijues tjetër përveç Allahut, ashtu pra nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Tij, *nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Tij*.

Për këtë, ato dy ajetet në fillimet e Sures El-Bekareh përfshijnë urdhërin për adhurim dhe ndalesën nga Shirku, dhe përfshijnë aprovimin e Teuhidit Rububijeh, domethënë që kjo është Vepra e Tij,

الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ ﴿٢١﴾

“Ju krijoi ju dhe ata që kanë qenë para jush” [Surja El-Bekareh, 21]

الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَّكُمْ ﴿٢٢﴾

“I Cili e ka bërë tokën vendpushim për ju dhe qiellin si kupë, dhe ju zbret nga qielli ujë, dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju” [Surja El-Bekareh, 22]

Këto janë Veprat e Allahut, Ai është i Vetmi në këto (vepra), pra atëherë obligohet që Ai të jetë i Vetëm në adhurim, dhe të mos adhurohen me Allahun të tjerë.

Teuhidi është tre llojesh:

Teuhidi Rububijeh, i cili është veçimi i Allahut me Veprat e Tij, pra që Ai është i Vetmi në Veprat e Tij, të cilat janë Krijimi, Rrizku, dhënia e jetës etj. Këto janë Veprat e Allahut.

Teuhidi Uluhijeh, është veçimi i Allahut me veprat e robërve, siç janë lutja, frika, shpresa, mbështetja. Këto janë veprat e robërve. Është obligim që të jenë vetëm për Allahun, dhe që i adhuruari të jetë Allahu, i Cili është i Vetëm dhe pa ortak.

Ndërsa lloji i tretë është *Teuhidi i Emrave dhe Cilësive* (të Allahut), dhe ajo është që të pohosh për Allahun atë që Ai ka pohuar për Vetën e Tij në Librin e Tij (Kur'anin) apo që e ka pohuar i Dërguari ﷺ në Sunnetin e tij, prej Emrave dhe Cilësive të Allahut, në atë pikëpamje që i përshtatet Përsosmërisë së Allahut dhe Madhështisë së Tij, pa e përngjasuar me krijesat, porse Cilësitë e Krijuesit janë siç i takojnë Përsosmërisë së Tij. Ndërsa cilësitë e krijesave janë siç i takojnë dobësisë dhe mangësisë së tyre.

Cilësitë e Krijuesit janë ashtu siç i takojnë Atij, ndërsa cilësitë e krijesave janë ashtu siç i takojnë atyre.

Siç ka thënë Allahu *Azze ue Xhel-le*:

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿١١﴾

“Asgjë nuk i ngjason Atij, dhe Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi” [Surja Esh-Shura, 11]

Në këtë fjali, në këtë ajet, ka pohim dhe distancim / pastrim (të Allahut nga çdo e metë).

Pohim për Dëgjimin dhe Shikimin (e Allahut), në Fjalën:

وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿١١﴾

“Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi”, dhe

distancim / pastrim nga çdo e metë për përngjasimin me krijesat, në Fjalën e Tij:

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ ﴿١٢﴾

“Askush nuk i ngjason Atij”.

Kjo është e vërteta në Emrat dhe Cilësitë e Allahut. Pra pohon Emrat dhe Cilësitë dhe njëkohësisht duke e mohuar përngjasimin me krijesat. Fjala e Tij:

وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿١١﴾

“Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi” është pohim, porse Fjala:

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ ﴿١٢﴾

“Asgjë nuk i ngjason Atij” është distancim i Allahut nga çdo e metë (çdo mangësi).

Domethënë ka Dëgjim ashtu siç i takon Atij, dhe ka Shikim ashtu siç i takon Atij, Dëgjimi i Krijuesit dhe Shikimi i Tij ashtu siç i takon Atij, dhe dëgjimet dhe shikimet e krijesave ashtu siç u takon atyre. Cilësitë e krijesave nuk ngjasojnë me Cilësitë e Krijuesit dhe as Cilësitë e Krijuesit nuk ngjasojnë me cilësitë e krijesave, porse Cilësitë e Allahut janë ashtu siç i takon Madhështisë së Tij dhe Lartmadhërisë së Tij, ndërsa cilësitë e krijesave janë ashtu siç u takon dobësisë dhe mangësisë së tyre. Pra ky ajet sqaron rrugën e saktë në lidhje me Emrat dhe Cilësitë (e Allahut) dhe ajo është pohim bashkë me distancim / pastrim (të Allahut) nga çdo e metë. Dhe kjo është mesatarja, e vërteta e mesme midis dy grupeve të humbura, e vërteta midis dy devijimeve, mesatarja midis dy devijimeve.

Haku pra është pohim bashkë me distancim / pastrim (të Allahut) nga çdo e metë, ndërsa dy devijimet të cilat janë:

pohimi bashkë me përngjasimin dhe distancimi bashkë me mohimin (e Cilësive të Allahut).

Pohimi bashkë me përngjasimin ... ky është devijim, dhe distancimi (i Allahut nga çdo e metë) bashkë me mohimin (e Cilësive të Allahut) janë devijim. Ndërsa pohimi bashkë me distancimin nga çdo e metë janë e vërteta në të cilën nuk ka dyshim, në përputhje me Fjalën e Allahut:

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿١١﴾

“Askush nuk është si Ai, Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi”.

وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿١١﴾

“Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi” është *pohim* dhe

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿١١﴾

“Askush nuk është si Ai” është *distancim nga çdo e metë*.

E vërteta është pohimi (i Cilësive të Allahut) bashkë me distancimin (e Tij nga çdo e metë), ndërsa e kota është pohimi (i Cilësive të Allahut) duke i shtuar edhe përngjasimin (e Cilësive të Tij me krijesat), (dhe gjithashtu e kotë është edhe): distancimi (i Allahut) nga çdo e metë duke i shtuar edhe mohimin (e Cilësive të Tij).

Gjithashtu përngjasimi dhe përshkrimi (i Cilësive të Allahut se ato janë si të krijesave) është devijim. Ndërsa pohimi (i Cilësive të Allahut) bashkë me distancimin (e Tij nga çdo e metë) është e vërteta.

Pohimi (i Cilësive të Allahut) e kundërshton mohimin (e Cilësive të Tij), dhe distancimi (i Allahut) nga çdo e metë e kundërshton përngjasimin (e Cilësive të Allahut me të krijesave).

Pohimi se

وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿١١﴾

“Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi”,

pra kemi pohuar Dëgjimin dhe Shikimin për Allahun dhe kjo e kundërshton mohimin (e Cilësive të Tij që e bëjnë disa grupe të devijuara).

Dhe nëse themi se

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ ﴿١٢﴾

“Askush nuk është si Ai”,

kuptimi i saj është se e kemi distancuar Allahun *Azze ue Xhel-le* nga përngjasimi me krijesat, pra haku (e vërteta) është në mes të dy devijimeve, të cilat janë devijimi i “mohimit” dhe devijimi i “përngjasimit”, sepse (e vërteta) është pohim dhe distancim.

Pohim, i cili nuk ka me të “mohim”, dhe distancim nga çdo e metë, i cili nuk kanë të “përngjasim”. Porse është siç ka thënë Allahu Azze ue Xhel-le:

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿١١﴾

“Askush nuk është si Ai, Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi” [Surja Esh-Shura, 11]

“Përngjasuesit” kanë pohuar dhe njëkohësisht kanë përngjasuar (Cilësitë e Allahut me të krijesave).

Thonë që Dëgjimi i Allahut është si dëgjimi jonë, dhe Shikimi i Tij është si shikimi jonë, ndërsa “Mohuesit” kanë bërë distancim (të Allahut nga disa të meta) dhe njëkohësisht kanë mohuar, e mohuan Krijuesin nga Cilësitë e Tij, sepse fjala *Teatil* (që ka lidhje me mohuesit e Cilësive të Allahut) është zbrazëti, domethënë “Mohuesi” është i zbrazët, i zbrazët nga çdo gjë. “Mohuesi” është ai i cili s’ka asnjë vepër, pa asnjë angazhim, pra Teatil është zbrazëti, ata (ja hoqën) e zbrazën Allahun nga Cilësitë e Tij. Pra ja mohuan Atij (Cilësitë) dhe e bënë Atë që të mos përshkruhet me Cilësitë e Tij, kjo është rruga e atyre që akuzojnë Allahun *Azze ue Xhel-le*. Atëherë pra “Mohuesit” dhe “Përngjasuesit” ranë në devijimin e përngjasimit, ndërsa “Mohuesit”, në fund ranë në devijimin e përngjasimit!

Porse ky përngjasim i tyre është më i rëndë se përngjasimi i “Përngjasuesve”, sepse ato kur ja mohuan Allahut Cilësitë, u bënë përngjasues për diçka që nuk ekziston, përngjasues për diçka që nuk ekziston, ia mbathën prej përngjasimit, pamja e së cilës është e kotë, përngjasimi me krijesat, dhe ranë në një përngjasim më të keq se ai, dhe ajo është *përngjasimi i inekzistentes*.

Dhe për këtë ka përmendur Ibn AbdulBerr në librin e tij *“Et-Temhid”*, ka thënë: *“Ata që i mohojnë Cilësitë (e Allahut), i përshkruajnë ata që i kanë pohuar (Cilësitë e Allahut) se janë “Përngjasues”.*”

I përshkruajnë ata që i kanë pohuar ato se janë “Përngjasues”, ata të cilët i mohuan ato i përshkruajnë ata që i kanë pohuar ato, se ata janë “Përngjasues”. Dhe siç e mësuam, nuk ka kundërshtim midis pohimit dhe përngjasimit, sepse ka pohim bashkë me përngjasim dhe pohim me distancim. Dhe pohimi me përngjasim është e kotë, dhe pohimi me distancimin është e vërteta.

Thotë Ibn AbdulBerr në librin e tij *“Et-Temhid”*:

“Ata që i mohojnë Cilësitë (e Allahut), i përshkruajnë ata që i kanë pohuar ato, se ata janë “Përngjasues”!”,

sepse ata nuk e përfytyrojnë pohimin vetëm se me përngjasimin, pastaj thotë: “ata”, pra mohuesit, për ata që i pohojnë ato (Cilësitë e Allahut), i konsiderojnë mohuesat të Adhruarit (Allahut), dhe për ata që i pohojnë ato (Cilësitë e Allahut), i konsiderojnë mohuesat të Adhruarit.

Kjo është fjala e Ibn AbdulBerr-it në librin *“Et-Temhid”*, Imami i Marokut në kohën e tij.

Dhehebiu, Allahu e mëshiroftë, në librin e tij *“El-Ulu”* ka sjellë këtë fjalë të Ibn AbdulBerr-it, dhe ka komentuar në të me fjalën e tij:

“Them: ka thënë të vërtetën Uallahi, se Mohuesit e mohojnë Allahun”, “ka thënë të vërtetën Uallahi”,

Pastaj e sqaroi këtë me një shembull:

Xhehmitë, mohuesit e Cilësive, shembulli i tyre është siç ka thënë Hammad ibn Zejd.

Shembulli i tyre është siç ka thënë Hammad ibn Zejd:

“Disa njerëz thanë se në shtëpinë tonë kemi një palmë.

I thanë atyre: “A ka gjethe?”

U përgjigjën: “Jo, nuk ka gjethe.”

I thanë atyre: “A ka degë?”

U përgjigjën: “Jo, nuk ka degë.”

I thanë atyre: “A ka fije?”

Thanë “Jo, nuk ka fije.”

I thanë atyre: “A ka trung?”

Thanë: “Jo, nuk ka trung.”

(i thanë atyre): “Atëherë në shtëpinë tuaj nuk ka palmë!””

Për aq kohë sa ajo nuk ka trung, e s’ka degë, e s’ka gjethe, e s’ka fije ... dhe të gjitha cilësitë e palmës, të cilat nuk i ka, atëherë nuk ka palmë tek ju! E as në shtëpinë tuaj nuk ka palmë!

Kështu është edhe me ata që thonë se Allahu nuk ka Dëgjim, e as Shikim, dhe as ... etj., domethënë kuptimi i saj është se ata e mohojnë të Adhuruarin (Allahun). Ia mbathën prej një përngjasimi të keq, dhe ai është përngjasimi i gjërave të gjalla me përfytyrim të kotë, ranë në një përngjasim më të keq dhe ai është përngjasimi me (cilësi) inekzistente.

Atëherë pra, këto janë tre llojet e Teuhidit:

Teuhidi Rububijeh, i cili është veçimi (besimi) i Allahut me Veprat e Tij, si Krijimi, Rizku. Ai është i Vetëm në këto Vepra, nuk ka ortak në to, e këto i kanë aprovuar (besuar) mosbesimtarët tek të cilët u dërgua Profeti ﷺ, porse (vetëm ky besim) nuk i futi në Islam.

Dhe i dyti është *Teuhidi Uluhijeh*, ai është i cili ka ndodhur për të mospajtimi midis Profetëve dhe popujve, mohuan dhe kundërshtuan dhe nuk besuan tek të Dërguarit, sepse ata i urdhëruan që ta veçojnë (adhurojnë të vetëm) Allahun me adhurim, porse ata dëshironin të ndiqnin fenë e baballarëve dhe gjyshërve të tyre.

Pastaj (i treti) është *Teuhidi i Emrave dhe Cilësive*, të cilën e njohëm. Atëherë pra këto dy ajete fisnike në fillimin e Sures El-Bekareh përmbajnë dhe përfshijnë rreth urdhëresës së parë në Kur'an dhe rreth ndalesës së parë në Kur'an.

E urdhëri më i madh është Teuhidi, e ndalesa më e madhe është Shirku. Dhe gjëja e parë që ftohet (në Islam), dhe gjëja e parë që ndalohet. Gjëja e parë që ftohet (në Islam) është Teuhidi dhe gjëja e parë që ndalohet (në Islam) është Shirku.

Gjithashtu (këto dy ajete) përmbajnë pohimin për Teuhidin Rububijeh si sqarim se Ai që është i veçuar me këto Veprime, dhe ato janë Krijimi, Rizku, zbritja e shiut, mbirja e bimëve, pra Ai është Ai i Cili e Meriton adhurimin, i Vetmi, i Cili nuk ka ortak.

Allahu i Lartësuar është më i Dituri, lavdërimet e shumta, bekimet dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi robin dhe të Dërguarin e Tij, Profetin tonë Muhammed dhe mbi të gjithë familjen dhe shokët e tij.

